

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr 1571/4 **VENDIMI**

V E N D I M

I GJYQTARES SE VETME

Ne Tirane, ne gjykatën e shkallës së parë, sot me datë 30.06, 2004, une gjyqtarja M. Ueesez, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga zoti Franko Saro Administratori i shoqerise "BIRRA KORCA" sh.p.k.,

K O N S T A T O V A

Se me Vendim nr.1571 date 11.02.1994 eshte regjistruar ne Regjistrin Tregetar shoqeria "BIRRA KORCA" sh.p.k.Ortakët (gjithesej 11), objekti veprimtarise, kapitali themeltar, kohezgjatja etj percaktohen ne Statutin dhe Akt Themelimit depozituar.

Me Vendimet nr.1571/1 date 10.06.1999, nr.1571/2 date 14.06.1999, nr.1571/3 date 01.12.2000 shoqeria ka depozituar ne Regjistrin Tregetar aktet e saj qe pasqyrojne nje sere ndryshimesh qe lidhen me zmadhimin e kapitalit themeltar, caktim te ekspertit kontabel per bilancet etj.

Me vendim nr.1571/4 date 16.07.2002, gjyqtarja e vetme ka vendosur « Mospranim te kerkeses se Administratorit per depozitim te vendimit te Asamblese se Ortakeve te dates 02.06.2002.Vendimi ka marre forme te prere me vendimin nr.115 date 24.10.2002 te gjykates se Apelit Tirane.

Sipas Statutit dhe Akt Themelimit, Ortak i shoqerise eshte edhe i ndjeri Thanas Qeleshi, vdekur me 07.12.1994, zoterue ne 1/11 pjese ose 9.1% te kuotave te kapitalit themeltar.

Me Vendim gjyqesor nr.1118 date 05.05.1995 te gjykates se shkalles se pare Korce, trashegimtare ligjore te radhes se pare te tij jane femijet Mihallaq Qeleshi dhe Katerina Malollari (Qeleshi).Ne baze te dispozitave mbi trashegimine ligjore ata trashegojne ne pjese te barabarta secili mbi te drejttat dhe detyrimet e trashegimlensesit. Sipas Ligjit 7638 date 19.11.1992 « Per Regjistrin Tregetar » dhe nenit 9 te Statutit te shoqerise ...pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme tek trashegimtarete ligjore....., Trashegimtarete e mesiperm fitojne te drejta pasurore mbi kuotat e kapitalit themeltar te trashegimlensesit ne pjese te barabarta secili perkatesisht ne 1/22 pjese ose 4.6 % te kuotave.

Administratori Franko Saro, kerkon pasqyrimin ne Regjistrin Tregetar te ndryshimit te mesiperm.Bashkengjitur kerkeses se tij, vendim gjyqesor nr.1118 date

05.05.1995, certifikate vdekje e trashëgimlënesit Ish Ortakut Thanas Qeleshi, dhe ato te lindjes se trashëgimtareve Mihallaq Qeleshi dhe Katerina Malollari (Qeleshi.)

Nga shqyrtimi i kërkeses dhe akteve bashkëngjitur, rezulton se kërkesa është e drejte dhe ajo duhet pranuar.

PER KETE ARESYE

Bazuar ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare" dhe Ligjin 7667 date 18.01.1993 "Per Regjistrin Tregetar dhe formalitetet"

VENDOSA

Pranimin e kërkeses se Administratorit Franko Saro per pasqyrim te ndryshimeve ne aktet e shoqerise « BIRRA KORCA » sh.p.k.ne lidhje me Ortaket e saj.

Trashëgimtarët ligjore te radhes se pare te trashëgimlënesit Ish Ortakut Thanas Qeleshi **fitojne cilesine e Ortakeve** si vijon :

1.Mihallaq Thanas Qeleshi, Ortak, zoterues ne 1/22 pjese ose 4.6 % te kuotave ne kapitalin themeltar te shoqerise « BIRRA KORCA »

2.Katerina Thanas Malollari (Qeleshi),Ortake, zoteruese ne 1/22 pjese ose 4.6 % te kuotave ne kapitalin themeltar te shoqerise « BIRRA KORCA ».

Urdherohet Zyra e Regjistrin Tregetar te beje ndryshimet e mesiperme.
Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me ngjyre te kuqe.

Kunder vendimit lejohet ankim baze ligjit.

GJYQTARE

